

1580
02.04.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr 4235/303 regj .themeltar

Nr 393 vendimi
Dt 03.03.2015

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese : Alkelina Gazidedja
Anëtare : Blerona Hasa
Anëtare : Rilinda Selimi

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Ivi Halipaj sot më dt 03.03.2015 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë :

PADITES: Klinika Mjekësore “AKS” sh.p.k me Nipt L12513003 me aktivitet shërbime mjekësore, shëndetësore, me seli ne lagjen “Kushtrim” Berat

TE PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Komisioni i Apelimit Tatimor Tirane

OBJEKTI: Shfuqizimi i “Njoftimit Vleresimit Tatimor te DRT Berat Nr. 2240 Port, dt. 21.07.2011 dhe vendimi Nr. 16519/1 Prot dt. 08.09.2011 te Komisionit Apelimit Tatimor Tirane

BAZA LIGJORE: Neni 324/a, 325, 327, 328, 331 K.Pr.Civile. Neni 109, 122/1 etj te ligjit Nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore Republike e Shqiperise” , i ndryshuar si dhe neni 116/c, 117, 137, etj K.Pr.Administrative.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat pasi ka marrë në shqyrtim çështjen administrative me vendimin përfundimtar Nr.1549 dt 29.12.2011 ka vendosur :

- Pranimin e padise.

Shfuqizimin teresishte te aktit administrativ: Njoftim vleresimi per Detyrim Tatimor te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat me Nr. 2240 Prot dt. 21.07.2011 dhe vendimin Nr. 16519/1 Prot dt. 08.09.2011 te Komisionit te Apelimit Tatimor Tirane si te pa bazuara ne prova dhe ne ligj Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen paleve ndergjyqese sic jane bere.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor 15(pesembedhjete) ditor prane Gjykates se apelit Vlore, duke filluar ecja e afatit ankimit per palet padites + i paditur nga dita e neserme e shpalljes.

Kunder vendimit ka bere ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e kerkesë padisë duke pretenduar se :

- Rezultoi e provuar gjate shqyrtimit gjyqesor se nga administrata tatimore jane respektuar te gjitha procedurat administrative per konstatimin e faktit dhe formalizimin e akteve. Konkretisht ne dt.05.07.2010 me aktin e konstatimit nr.0182921, grupi i kontrollit i verifikimit ne terren ka konstatuar mungesen e pajisjes fiskale ne vendin e ushtrimit te aktivitetit te paditesit.Me tej eshte ndjekur procedura e plote deri ne nxjerrjen e aktit administrativ nr. 2240 dt. 21.07.2011 i DRT Berat, kjo ne baze te nenit 122 pika l germa "a ,i" te ligjit 9920 date 19.05.2008 (i ndryshuar), duke percaktuar nje penalitet prej 100.000 lekesh. Keto akte jane te drejte e te bazuara ligjerisht dhe pikerisht shkeljes se konstatuar i pergjigjet edhe baza ligjore e aplikuar, neni 122/1 germa "a, i". Kjo dispozite parashikon penalitet ne shumen 100.000 leke per tatim paguesin qe nuk instalon pajisjen fiskale heren e pare te konstatimit te faktit. Detyrimi ligjor per pajisjen me kase parashikohet edhe ne nenin 55 te ligjit 9920 dt. 19.05.2008. Pershkruhet me hollesisht ne Udhezimin 24 date 02.09.2008 i nxjerre ne funksion te ligjit. Po ne nenin 55 te Udhezimit theksohet detyrimi per pajisjen ne kase ne perputhje dhe me VKM 781 date 14.11.2007, te ndryshuar. Siç e theksuam, ne kete VKM, pervec detyrimit te pajisjes me rregjistrues elektronik fiskal, percaktohen dhe afatet kohore te instalimit. Pretendimet e paditesit nuk justifikojne ne menyre ligjore mos pajisjen me kase fiskale.
- Ne lidhje me pretendimin per afatin 10 ditor ku paditesi pretendoi se midis konstatimit dhe penalitetit duhet te kete afat 10 ditor pune, theksojme se kjo djspozite eshte referuese. Ne rastin tone i referohet VKM 781 te sipercituar, por edhe Ligjit "Per Q.K.R.-ne" ne te cilin gjithashtu percaktohen modalitetet e regjistrimit. Tatimpaguesi ne momentin e aplikimit per rregjistrim prane QKR ka nenshkruar edhe formularet perkates, pjese e se ciles eshte edhe deklarimi i tatimpaguesit (paditesit) se njeh dhe pranon kuadrin ligjor fiskal. Pra, jo 10 dite, por me shume se gjashte muaj kane kaluar nga mospermbushja e detyrimit ligjor te percaktuar ne VKM-ne dhe ne kuadrin ligjor te sipercituar. Afat i percaktuar ne veshtrim te nenit 122 pika l germa "a,i" te Ligjit per Procedurat Tatimore, do te konsiderohet afati kohor i vendosur per instalim te paisjes fiskale ne VKM-ne 781 dt. 14.11.2007 (e ndryshuar). Sic rezultoi nga qendrimi perfundimtar i paditesit, ai eshte njoftuar per detyrimin e paisjes me kase. Gjithashtu vertetohet pasja dijeni e paditesit per

- detyrimin ligjor per paisjen me kase fiskale edhe nga kontratat e lidhura prej tij me njerën nga shoqerite e autorizuar, ku theksohet qarte detyrimi ligjor sipas VKM 781. Givkata ben interpretim te gabuar te ligjit duke pranuar pretendimin e paditesit ne lidhje me lenien e nje afati 10 ditor nga konstatimi i shkeljes deri ne vendosjen e penalitetit. Ne kete veshtrim afati i lenë paditesit nga administrata tatimore eshte disa fish me i larte se ai i percaktuar ne nenin 122 te Ligjit per procedurat tatimore.
- Vertëtohet ne kete menyre se asnje pengese objektive apo shkak ligjor nuk ka ndikuar qe paditesi te permbushë detyrimin e tij per vendosjen e paisjes fiskale.

Kunder vendimit ka bere ankim Avokatura e shetit e cila kërkon ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e kerkesë padisë duke pretenduar se:

- Vendimi gjyqesor nr.1549 date 29.12.2011 te Gjykates se Shkalles se Pare Rrethit Gjyqesor Berat eshte i pabazuar ne ligj dhe ne prova.
- Vendimi i gjykates se shkalles se pare nuk eshte i bazuar ne ligj pasi siç doli e provuar gjate shqyrtimit te ceshtjes administrata tatimore i ka respektuar te gjitha procedurat administrative per konstatim te faktit dhe me tej per formalizim te akteve administrative.
- Paditesi nuk paraqiti asnje prove per te vertetuar pretendimin e tij se akti i njoftimit te vleresimit eshte i padrejte dhe i pambeshtetur sepse detyrimi ligjor dhe afatet kane ngelur te pandryshuara
- Per palen paditese ne cdo moment ka qene e mundur pajisja me kase fiskale dhe realizimi i ketij procesi nga te pakten prej nje prej shoqerive te autorizuar. Ishte detyrim ligjor i paditesit te vendose kase duke shfrytezuar cdo menyre dhe kjo gje eshte e pranuar dhe nga paditesi i cili pretendoi se kishte qene ne pamundesi per ta vendosur kasen ne momentin qe kishte marre edhe licensen.
- Te gjitha veprimet e paditesit pas regjistrimit ne muajin shkurt te vitit 2011 kane qene te tille qe nuk kane realizuar detyrimin ligjor per tu pajisur me kase fiskale. Ne te tilla rrethana edhe vendosja e gjobes nga ana e Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat ka qene e drejte

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e ceshtjes nga gjyqtarja Alkelina Gazidedja, shqyrtoi ceshtjen në dhomë këshillimi

VËREN

Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj Nr 550 dt 01.04.2014 vendimi ka vendosur në bazë të nenit 61 të K.Pr.Civile : “Te shpalle moskompetencen e Gjykates se Apelit Vlorë dhe dergimin e ceshtjes per kompetence Gjykates Administrative te Apelit Tirane”

Në këto kushte kjo çështje u gjykua nga Gjykata Administrative e Apelit, në zbatim edhe të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë Nr 3 dt 6.12.2013.

Nga shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumentave, Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit cmon se vendimi Nr 1549 dt 29.12.2011 i Gjykatës së Shkallës së Parë Berat është marrë në zbatim të ligjit dhe të provave, shkaqet e ankimit të paraqitur nga pala e paditur nuk qëndrojnë me arsyetimin si më poshtë vijon :

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton e provuar se :

Klinika Mjeksores "AKS" e ndodhur ne lagjen "Kushtrim" Berat, e themeluar ne Janar te vitit 2011 me NIPT L12513003 F me objekt aktiviteti Sherbime mjeksores, shendetesore rezulton te jete e rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne fund te muajit Janar po te vitit 2011. Ndersa ne fund te muajit shkurt Klinika AKS (paditesi) ka marre dhe licensen profesionale per ushtrim aktiviteti privat ne perputhje me objektin e aktivitetit .

Ne muajin Mars - Qeshor pala paditese ka kryer blerjen e paisjeve mjeksores te domosdoshme per kryerjen e sherbimeve, me pas vazhduar me instalimin e ketyre paisjeve. Provohet gjate gjykimit se Klinika Mjeksores AKS ka filluar te ofroj sherbime, konforme objektit te aktivitetit per qytetaret ne dt. 01.07.2011. Subjekti Klinika Mjeksores "AKS" sh.p.k Berat eshte me seli ne lagjen "Kushtrim" Berat dhe ortak te vetem ka administratoren z. Aferdita Numani.

Ne baze te ligjit, subjektet qe ushtrojne veprimtarite e tyre, me leke ne dore duhet qe ta pasqyrojne ate nepermjet rregjistrimit ne paisje fiskale.

Ne dt. 04.07.2011 me " Fature tatimore shitje " Nr. 458 subjekti Klinika Mjeksores "AKS" ka blere kasen fiskale nga subjekti i licensuar BNT Elektronik.

Ka rezultuar në gjykim në shkallë të parë se ne dt. 05.07.2011 prane pales paditese Klinika Mjeksores "AKS" sh.p.k eshte ushtruar kontroll nga inspektoriati i Vleresimit ne Teren te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat i cili ka mbajtur " Proçes verbalin" Nr. 0182921 dt. 05.07.2011 dhe ne permbajtje evidentohet fakti i mosinstalimit te Kases fiskale ne Klinike.

Ne dt. 23.07.2011, nepermjet sherbimit postar subjektit Klinika "AKS" sh.p.k i eshte komunikuar njoftimi i vleresimit per Detyrimin Tatimor nr. 2240 prot dt. 21.07.2011 dhe e penalizuar ne 100.000 leke gjobe.

Pala paditese ka ushtruar ankim prane Drejtorisë së Apelimit Tatimor, e cila me vendimin nr. 16519/1 Prot dt. 08.09.2011 ka vendosur lenien ne fuqi të "Njoftim vleresimit per detyrimin Tatimor" te nxjerre nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.

Kolegji administrativ ndryshe nga sa pretendon pala e paditur dhe avokatura e shtetit në ankim (prapësime të cilat kanë qenë parashtruar gjatë gjykimit në shkallë të parë) çmon se akti adminsitrastiv " Njoftim vleresimi per detyrimin tatimor " Nr.2240 Prot dt.21.07.2011 rezulton te jete akt absolutisht i pavlefshem, per arsye se eshte marre ne kundershtrim te hapur me

procedurat tatimore te percaktuara ne ligj dhe pikerisht ne nenin 122/1/i te ligjit te mesiperme kjo dispozite shprehet se : " Tatim paguesi, person fizik ose juridik, tregetar ne rast se; a. nuk instalon pasijen fiskale per rregjistrimin e pagesave me para ne dorë:

i. Heren e pare te konstatimit te mosinstalimit te pasijes fiskale, per te cilen eshte percaktuar nje afat vendosjeje deri ne 10 dite pune, me gjobe ne masen 100.000 (njeqindmije) leke.

ii. Heren e dyte te konstatimit te mosinstalimit te pasijes fiskale pas mosprespektimit te afatit te pare 10 ditor dhe kur per kete pasije eshte percaktuar nje afat vendosjeje tjeter deri ne 10 dite pas vendosjes se gjobes se pare, sipas nenndarjes " I" te shkronjes " a" te kesaj pike me gjobe ne masen 500.000 (peseqindmije) leke

Ne interpretim te permbajtjes se kesaj dispozite te posacme duket qarte se organi tatimor ne rastin e pare konstatimit te mosinstalimit te pasijes fiskale perpilon proces verbalin e konstatimit te mosinstalimit te pasijes fiskale, mban "Proces Verbalin e Konstatimit" me subjektin inspektues ku i vendos nje afat 10 ditor per instalimin e pasijes fiskale, ne te kundert ne rastin e mosvendosjes se pasijes brenda afatit te caktuar sipas ligjit prej 10 dite ateher si rezultat i ketij mosveprimi, ky veprim konsiderohet si veprim i kundraligjshem i cili perben kundravajtje administrative dhe rrjedhimisht subjekti penalizohet.

Kolegji administrativ cmon se neni 122/1 e vijes i ligjit Nr. 10209 dt. 23.12.2009 "Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr. 9920 dt. 19.05.2008 " Per procedurat tatimore ne Republikene Shqiperise", te ndryshuar , ndryshe nga sa pretendon i padituri, normon dhe vendos ne afat aplikim penaliteti dhe nuk penalizon subjektin per shkak te afatit 10 ditor te rregjistrimit si subjekt privat apo te kalimit te afatit 10 ditor te percaktuar ne vendosjen e pasijes fiskale nga subjektet, por e penalizon kur kerkon afati i vendosur nga organi tatimor per vendosjen e pasijes fiskale. Per pasojë, ligjevenesit pavaresisht te mosrespektimit te detyrimit ligjor per vendosje e pasijes fiskale, nga subjekti i ka normuar detyrimin qe organi tatimor para se te aplikoj penalizimin duhet te caktoj afatin 10 ditor per vendosjen e pasijes fiskale i cili ne rastin konkret nuk eshte zbatuar prej inspektorëve të palës së paditur e për rrjedhojë me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se akti është absolutisht i pavlefshëm

Në bazë të nenit 56 të ligjit nr 49/2012 ndaj këtij vendimi nuk lejohet rekurs në gjykatën e Lartë pasi akti përmban një detyrim në vlerën 100.000 lekë pra më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi. (22000x40 = 880000 leke)

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar ne Nenin 50/b te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative":

VENDOSI

Lënë ne fuqi te Vendimit 1549 dt 29.12.2011 te Gjykares se Rrethit Gjyqesor Berat.
Ndaj ketij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

U shpall sot ne Tirane me 03.03.2015

ANËTARE

Rilinda SELIMI
DV

ANËTARE

Blerona HASA
DV

KRYESUESE

Alkelina GAZIDEDJA
DV

NJESUAR ME ORIGINALIN
KANCELARI
LEONARD STRATAJ